



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD**

---

**GJS-2023-010**

**Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës-Mejreme Memaj**, bazuar në nenin 9 par.1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga R.Zh., për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, më 9 qershor 2023, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paraqitur nga R.Zh., ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – N.K..

**A r s y e t i m**

Ankuesi R.Zh., nga Gj., përmes postes elektronike i është drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës me 23 maj 2023 me ankesë ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, të cilën ankesë Këshilli ia ka përcjellë autoritetit kompetent U.D. Kryetares së Gjykatës Supreme me 24 maj 2023.

Parashtruesi i ankesës pretendon se Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë – N.K., ka marrë aktvendimin AGJ.nr.124/2023 datë 27.04.2023 që është në kundërshtim me Ligjin nr.03/1-999, për arsye të vendosjes me dy standarde në vendimmarrje në kërkesën e tyre të bërë me 19.12.2022 për përjashtimin e gjyqtares M.Sh.. Kështu, sipas ankuesit, Kryetari nuk e ka zbatuar drejt Ligjin dhe Kushtetutën sepse pas kallëzimit të tyre të bërë në prokurori ndaj gjyqtares kanë ndryshuar rrethanat tjera të cilat e vejnë në dyshim paanësinë e saj. Në fakt kryetari përdor dy standarde në vendosje sepse me aktvendimin PPP.nr.54/2022 e ka aprovuar kërkesën për përjashtim për të njëjtat arsye për shkak të kallëzimit penal të bërë në prokurori. Me tej sipas ankuesit Kryetari ka shfaq edhe aversion diskriminues fetar, ngase ndaj kërkesës drejtuar gjykatës nga pjesëtarët e komunitetit katolik kërkesa për përjashtim është aprovuar, dhe këto shkelje përmbajnë edhe elemente të veprës penale. Përveç kësaj në Gjykatën Themelore në Gjakovë bëhen të plotfuqishme aktvendime të cilat nuk kanë marr formë të prerë. Ankuesi ka kërkuar që këto shqetësime të adresohen tek organi i akuzës.

Meqenëse ankuesi përveç pretendimeve për shkelje disiplinore konsideron së këto veprime konsumojnë edhe vepër penale si autoritet kompetent fillimisht kam shqyrtuar ankesën në këtë

drejtim dhe pas shqyrtimit të bazës faktike dhe juridike të shkeljes së supozuar disiplinore në drejtim të elementeve të veprës penale vlerësoj se shkelja e supozuar disiplinore nuk përmban elemente të veprës penale, prandaj çështjen nuk e kam referuar tek prokurori i shtetit por kam filluar shqyrtimin për shkeljet e pretenduara disiplinore.

Me qëllim të vërtetimit bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj të pretendimeve sa i përket shkeljeve disiplinore si autoritet kompetent kam kërkuar nga kryetari i gjykatës të deklarohet lidhur me këtë rast dhe kam pranuar deklaratën e tij.

Në deklaratën e tij kryetari N.K., thekson se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara. Aktvendimin AGJ.nr.124/23 me të cilin e ka refuzuar kërkesën e ankuesit për përjashtimin e gjyqtarës M.Sh., e ka marrë pasi që Gjykata e Apelit ka vendosur fillimisht lidhur me kërkesën e palëve paditëse Sh.P. e S.M., të cilët kanë kërkuar përjashtimin e Gjykatës, kurse Gjykata e Apelit duke vendosur përkitazi me këtë kërkesë e ka refuzuar atë. Pastaj, aktvendimin për përjashtimin e gjyqtarës e ka marrë konform autorizimeve ligjore bazuar në nenin 70 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe pas vlerësimit të kërkesës dhe deklaratës së gjyqtarës ka konkluduar se nuk ka bazë ligjore për përjashtim me arsyetim që është dhënë në aktvendim. Po ashtu lidhur me kallëzimin penal që ankuesi e ka parashtruar ndaj gjyqtarës M.Sh., ka vendosur Prokuroria Themelore në Gjilan, e cila me aktvendimin PP.I.nr.51/2023 datë 14.04.2023 e ka hedhë poshtë.

Sa i përket faktit se ka përdor dy standarde ngase në aktvendimin PPP.nr.4/2022 kërkesën e ka aprovuar për arsye të njëjta për shkak të paraqitjes së kallëzimit penal, kjo nuk qëndron sepse ky aktvendim nuk është marrë nga ai si kryetar, por nga gjyqtarja e cila punon në çështje përmbartimore, të cilin vendim e ka marrë në kuadër të autorizimeve ligjore që ka. Madje lidhur me këtë çështje ankuesin e ka takuar me 4.07.2022 në të cilin ai ka pas vërejtje lidhur me vendimin e gjyqtarës në çështje përmbartimore, dhe e ka njoftuar se bazuar në Ligjin për Procedurën Përmbartimore kompetent për të vendosur për kërkesat për përjashtim të përmbartuesit privat është gjyqtarja e procedurës përmbartimore, e jo kryetari i gjykatës. Kurse, pretendimet se ka shfaqur aversion diskriminues fetar me arsyetim se me kërkesat për përjashtim drejtuar gjykatës nga pjesëtarët e komunitetit katolik aprovohen, ndërsa të tjerat refuzohen janë vetëm shpifje të ankuesit, për të cilat do të ndiqen rrugët ligjore. Si kryetar gjykate ka vendosur vetëm për aktvendimin AGJ.nr.124/23 për përjashtimin e gjyqtarës M.Sh., ku palë paditëse janë Sh.P., e S.M., nga Republika e Shqipërisë kurse të paditur janë R.Zh., Xh.Zh. e B.Zh., nga Gjakova. Po ashtu janë të pabazuara pretendimet se aktvendimet bëhen të plotfuqishme pa marrë formën e prerë, për faktin se me dispozitat ligjore dihet si bëhen të plotfuqishme vendimet gjyqësore dhe në kompetencë të kujt është që të vendos vulën e plotfuqishmërisë, pra është e referentit përkatës, e jo e Kryetarit të Gjykatës. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.302/2015 datë 19.06.2017, është bërë i plotfuqishëm me datë 7.10.2021 sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4500/2017 datë 7.10.2021, pasi që aktgjykimi ju është dorëzuar palëve, e jo ashtu siç ka deklaruar ankuesi, dhe këtë fakt e argumenton edhe referenti i lëmisë civile. Deklaratës ia ka bashkëngjitur aktvendimin AGJ.nr.124/23, aktvendimin PPP.nr.54/2022, aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.I.nr.51/2023 si dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.4500/2017.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së kryetarit dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitur deklaratës, vlerësoj se në rastin konkret nuk ka vend për të hapur procedurë disiplinore.

Në fakt ankesa është dukshëm joserioze, ngase nuk kemi një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur ankesa për shkelje disiplinore të kryer nga kryetari i Gjykatës, dhe për me tepër këto pretendime nuk argumentohen.

Kurse, të thënat e ankuesit demantohen nga provat të cilat Kryetari i Gjykatës ia ka bashkëngjitur deklaratës së tij. Kështu, nuk rezulton se Kryetari i Gjykatës ka vendosur me dy standarde sa i përket kërkesave për përjashtim, ngase del qartë se kryetari ka vendosur vetëm sa i përket kërkesës për përjashtim të gjyqtarës M.Sh., ( aktvendimi AGJ.nr.124/23), kurse aktvendimin PPP.nr.54/2022 e ka marrë gjyqtarja e procedurës përmbarimore, e të cilat vendime janë marrë në kuadër të autorizimeve të tyre ligjore. Nga ky fakt del të jetë i pabazuar edhe pretendimi se Kryetari i Gjykatës ka shpreh aversion diskriminues fetar. Pastaj, as pretendimi se aktvendimet në Gjykatën Themelore në Gjakovë behën të plotfuqishme pa u bërë të formës së prerë nuk argumentohet dhe rezulton të jetë tërësisht i pabazuar, aq me tepër kur sipas dispozitave ligjore kjo fushë nuk bie në kompetencë të kryetarit.

Pastaj, ankesa në rastin konkret ka të bëjë me pakënaqësinë e ankuesit rreth vendimit të marrë nga Kryetari i Gjykatës për përjashtim të gjyqtarës, në këtë drejtim si autoritet kompetent nuk është në kompetencën time të vlerësoj mënyrën e vendosjes se kryetarit, ngase Kryetari i Gjykatës dhe gjyqtarët janë të pavarur me rastin e vendosjes në çështjet që zhvillohen në gjykatë.

Pra, vlerësoj se nga ankesa e paraqitur nuk rezulton asnjë dyshim se Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë ka kryer shkelje disiplinore.

Nga arsyet e cekura, e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 nënpar. 3.2 të Rregullores së KGJK-së, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj  
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë,
3. Nënkryetares së Gjykatës Themelore në Pejë
4. Parashtruesit të ankesës
5. Arkivit të Gjykatës Supreme.